



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 93, Datë 16.12.2022

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-------------------------------|---------|
| - Znj. Klotilda Neziri | Kryetar |
| - Znj. Anairda Arizaj | Anëtar |
| - Z. Gentjan Thoma | Anëtar |
| - Znj. Blerta Çani (Drenofci) | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 16.12.2022, vazhdoi shqyrtimin e ankesës së konsumatorit K. Sh. kundrejt Institucionit të Arsimit të Lartë jo publik (IAL) "Luarasi". Ankesa konsiston në pretendimin për përmbajtje të kushteve të padrejta në kontratën standarde me IAL "Luarasi", për mos kthimin e shumes së paguar, në rast të heqjes dore nga studimi, përpara përfundimit të vitit studimor akademik 2021-2022.

VËREN SE:

Konsumatori K.Sh. me anë të Postës Shqiptare, ka paraqitur pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve (me poshtë Komisioni), një ankesë kundrejt IAL "Luarasi". Ankesa u administruar nga Komisioni me nr. prot. (KMK) 71, datë 09.05.2022.

Konsumatori/studenti K.Sh. ka lidhur kontratë me IAL "Luarasi", për ndjekjen e studimeve në vitin akademik 2021-2022, duke paguar tarifën e plotë për gjithë vitin akademik. Mbas përfundimit të javës së parë të vitit studimor, studenti konstatoi dhe vlerësoi pamundësinë e vazhdimin të studimeve, prandaj kërkoi nga IAL "Luarasi", të plotësonte formularin e çregjistrimit dhe rimbursimin e shumës për shërbimet e pa marra. Konsumatori merr përgjigje nga subjekti, se në bazë të kontratës të nënshkruar nga vetë ai, nuk ka të drejtën të tërhiqet nga kontrata dhe as të përfitojë vlerën e shërbimit të papërfutur.

Konsumatori referuar Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar si dhe Vendimit të KMK nr. 61, datë 11.07.2017 "Për vlerësimin e kushteve të "Kontratës së Shërbimit ndërmjet Studentit dhe IAL "LUARASI"" ngre pretendimin për përmbajtje të kushteve të padrejta në kontratën e IAL "Luarasi", si dhe kërkon rimbursimin e shumës për shërbimin e pa marrë.

- **Lidhur me kompetencën e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit**

Së pari, IAL "Luarasi", është një institucioni i arsimit të lartë Jo publik është SHPK, me (NUIS) K31526058G dhe që ushtron aktivitetin bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", krijuar me VKM Nr. 611, datë 11.09.2003 "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Jopublike "Luarasi".

Në kuptim të përkufizimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 e ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve" (LMK), subjektet operuese në fushën e arsimit të lartë (IAL) plotësojnë kërkesat për tu përcaktuar si 'tregtarë', pasi janë subjekte që veprojnë për qëllime që lidhen me veprimtarinë e tij ekonomike dhe/ose tregtinë. Studentët, të cilët lidhin kontratë shërbimi me IAL, në kuptim të pikës 6, nenit 3 të ligjit 9902/2008 janë konsumator, pasi ata përfitojnë një shërbim nga IAL për plotësimin e nevojave vetjake që nuk ka lidhje me veprimtarinë e tyre tregtare.

Së dyti, çështja objekt shqyrtimi, pasi konsiston në një marrëdhënie midis tregtarit dhe konsumatorëve dhe rrjedhimisht brenda fushës së zbatimit të ligjit "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar dhe në kompetencë të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Së treti, kontrata e Shërbimit lidhur midis IAL "Luarasi" dhe studentit është Kontratë Standarde e lidhur midis një subjekti/tregtari dhe konsumatorit. Kushtet e përcaktuara në të janë të parapërgatitura nga tregtari, ku konsumatori/studenti shpreh miratimin e tij duke e nënshkruar kontratën dhe nuk negocion për kushtet e parashikuara në të.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se, shqyrtimi i ankesës së lartpërmendur është në kompetencë të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1444, datë 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve", pika 3, shkronja (d) parashikon se:

"3. Komisioni ka përgjegjësinë të shqyrtojë shkeljet e ligjit nr.9902, datë 17.4.2008, për:
a)) kushtet e padrejta në kontratat me konsumatorët;"

- **Vlerësimi i praktikës tregtare**

Komisioni ka marrë nëpërmjet postës zyrtare ankesën e konsumatorit K.Sh. kundrejt IAL "Luarasi". Në mbledhjen e datës 05.07.2022, Komisioni vendosi fillimin e procedimit administrativ. Me anë të shkresës me nr. 71/1 Prot. (KMK), datë 25.07.2022, subjekti IAL "Luarasi", ka marrë njoftimin përkatës, e i është vënë në dispozicion ankesa, si dhe i është kërkuar një informacion i plotë sqarues, kontrata standarde, kontrata me konsumatorin K.Sh,

si dhe çdo dokumentacion tjetër, që mund disponohej nga ana e subjektit mbi këtë praktikë. Për praktikën është vënë në dijeni edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).

Komisioni në mbledhjen e datës 16.12.2022, mori në shqyrtim përgjigjen e paraqitur nga IAL "Luarasi", kontratën e regjistrimit, kontratën paraprake të regjistrimit, si dhe kërkesën e konsumatorit për çregjistrim, vënë në dispozicion të KMK me anë të shkresës së administruar nga KMK me nr. prot. 71/2, datë 22.8.2022.

Në përgjigjen e subjektit sqarohet se, konsumatori ka nënshkuar dy aktet ligjore (kontratën e regjistrimit, kontratën paraprake të regjistrimit) ku përcaktohet qartë pagesa dhe mënyra e shlyerjes së saj. Gjithashtu, ngrihet pretendimi se ndryshimi i çmimit të pagesës dhe i pasojave juridike të saj në dy aktet ligjore vërtetojnë faktin se kontrata ka qenë e negociuar ndërmjet palëve. Në kontratë parashikohet dispozita për rimbursim të plotë të studentit pagesat e bëra për ndjekjen e orës se pare te mësimi ose 7 dite pas nënshkrimit të kontratës së regjistrimit, cilado prej këtyre datave të jete me e vonshme.

Në shqyrtimin administrativ, Komisioni mori në konsideratë faktin, se për sa i takon kontratës standarde të lidhur midis IAL "Luarasi" dhe studentit, Komisioni ishte shprehur nëpërmjet Vendimit nr. 61, datë 17.11.2017 "Vlerësim i kushteve të përgjithshme të "Kontratës së Shërbimit ndërmjet Studentit dhe IAL "LUARASI"". Për këtë arsye vlerësimi i zbatimit të këtij vendimi tek kontrata në fuqi e subjektit me studentët, u bë pjesë e këtij shqyrtimi administrativ.

Komisioni konstatoi se, nëpërmjet pikës 2 të vendimit të KMK 61/2017, lidhur me rimbursimin e studentëve, i ka kërkuar IAL "Luarasi", që:

"Të qartësohen në kontratë rastet e rimbursimit, pasi është i padrejtë dhe joproporcional parashikimi se asnjë pagesë nuk kthehet. Kur studenti nuk mund të marrë shërbimin nga tregtari, apo për raste të justifikuara, studentit duhet t'i rimbursohet pagesa që ka kryer."

Për sa me sipër, Komisioni vlerëson se, megjithëse subjektit IAL "Luarasi", në pikën 5 të Vendimit të KMK 91/2017, i është kërkuar merrja e masave për zbatimin e vendimit, në kontratën standarde në fuqi të IAL "Luarasi" me studentët (kontrata e regjistrimit), përsëri mungonte parashikimi i dispozitës, për sa i takon rimbursimit në rastin e një shërbimi të paofruar nga subjekti ose/dhe të pa marrë nga studenti.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, mbështetur në nenet 27, 28, 52 e 55 të Ligjit 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, dhe pikat 2 dhe 6 të VKM nr. 1444, dt. 22.10.2008 "Për mënyrën e funksionimit e te pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve",

VENDOSI:

1. IAL "Luarasi" të marrë masat për zbatimin e pikës 2 të Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve nr. 61, datë 19.11.2017: "për të qartësuar në kontratë rastet e rimbursimit, pasi është i padrejtë dhe joproporcional parashikimi se asnjë pagesë nuk kthehet. Kur studenti nuk mund të marrë shërbimin nga tregtari, apo për raste të justifikuara, studentit duhet t'i rimbursohet pagesa që ka kryer".
2. IAL "Luarasi" të njoftojë KMK për masat e marra për zbatimin e vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve keni të drejtë të ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

KLOTILDA NEZIRI

